



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:267356

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05389130

C.nr.4606/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale D.A. në çështjen juridiko – kontestimore të paditëses A.D. me numër personal nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët e saj nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal Prizren, për shkak të kompensimit të pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,337.26€, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 28.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. RFUZOHET si e pa bazuar** kërkesëpadia e paditësit A.D. nga Prizreni me të cilën ka kërkuar që të:” ***DETYROHET e paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal - Prizren, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në punë, t’ia paguajë (kompensojë) 1 (një) pagë mujore neto, në shumë prej 1,337.26 € me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë gjerë në pagesën definitive të saj si dhe shpenzimet e procedurës të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.***”
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A.D. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët e saj, me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate, me dt.12.05.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shpërblimit jubilarë, vlera e kontestit 1,337.26 € (njëmijë e treqind e tridhjetë e shtatë euro e njëzetë e gjashtë cent).

I autorizuari i paditësit në padi ka theksuar se paditësi A.D. është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura, për më tepër se 10 vite në SHSKUK, në Prizren. E paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren edhe përkundër obligimeve, përkatësisht fitimit të së drejtave të cilat rrjedhin nga Kontratën Sektoriale e nënshkruar me 12.06.2018, mes Qeverisë së Kosovës-Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Ligjit të Punës (nenet 4, 10, 11, 55, 90) dhe kontratës individuale, nuk e ka bërë kompensimin e 1 (një) page neto, ashtu siç i takon sipas përvojës së punës. Lartësia e llogaritjes së një page neto për shpërblimin jubilar, mbështetet në realizimin e pagës në muajin e fundit të paditësit. Sipas të autorizuarit të paditësit paga mujore neto e të njëjtit është 1,337.26 €, e sipas përvojës i takon shuma e përgjithshme prej 1,337.26€. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet, i

ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se paditësi marrëdhënien e punës në Spitalin e Prizrenit e ka filluar nga data 02.05.2019 ku edhe vazhdon të punojë, ndërsa pjesën tjetër të përvojës së punës nuk është në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit, periudha e punës është 6 vite 6 muaj dhe 0 ditë (duke filluar nga data 01.12.2010), duke shtuar se paditësi kërkesëpadinë e bazon në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive në nenin 52 dhe 53 e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka rregulluar shumë çështje nga marrëdhënia e punës. Me dispozitat e nenit 52 të MPKK është paraparë që i punësuar i ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë për 10, 20 dhe 30 vjet të përvojës së punës së pandërprerë tek punëdhënësi i fundit, në shumë të 1, 2 ose 3 pagave mujore të tij. Ndërsa në dispozitat e nenit 52 par 3 parashihet se shpërblimet jubilarë paguhen në afat prej 1 muaji, pas plotësimit të kushtit nga ky paragraf. Kjo do të thotë se shpërblimet jubilarë paguhen në afat prej një muaji prej ditës kur i punësuar i mbush 10, 20 dhe 30 vjet pune pandërprerë me rastin e jubileut, të ashtuquajturit “Vit jubilar”. Në rastin konkret, paditësi marrëdhënien e punës e ka themeluar më 02.05.2019 tek punëdhënësi i fundit, ndërsa tek punëdhënësi paraprak i ka gjithsej 6 vite e 6 muaj e 0 ditë përvojë, ku mund të konstatojmë se paditësi tek i padituri 10 vjet përvojë pune i ka mbushur me 01.11.2022, ky vit për të cilin ka qenë jubilar dhe vit në të cilin marrëveshja kolektive nuk ka qenë në fuqi, afati i së cilës ka përfunduar me datë 12.06.2021. Sa i përket pagesës për shpërblimet jubilarë bazuar në ligjin e punës neni 87 Afati i parashkrimit, thuhet se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, pasi që paditësi padinë e ka parashtruar me datë 12.05.2023. Andaj, sipas kësaj paditësit nuk i takon e drejta në pagesën e shpërblimit jubilar. Shuma e kërkuar nga pala paditëse është llogaritur në mënyrë paushalle pasi që paga bazë mujore e paditësit është 1,200.00€ e jo 1,337.26€ sepse në vlerën 1,337.26€ janë llogaritur edhe orët shtesë. Sipas të lartcekurave paditësit nuk i takon e drejta në pagesën e shpërblimit jubilar. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, sepse nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë.

Për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi është marrëdhënie pune pranë të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, të njëjtën e ka filluar me datë 02.05.2019 ku edhe vazhdon të punojë, ndërsa pjesa tjetër e përvojës së punës nuk është në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit, periudha e punës është 6 vite e 6 muaj dhe 0 ditë. Po ashtu paga bazë e të njëjtit në SPZ është 1,226.00 €, fakte këto të vërtetuara nga provat (vërtetimi, lartësia e pagës bruto dhe neto, kontrata e punës e lidhur mes palës paditëse dhe palës paditur) të cilat gjenden në shkresat e lëndës të dorëzuara nga pala paditëse dhe e paditura me përgjigjen në padi.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: vërtetimi nr.1351 i datës 03.05.2022 lëshuar nga e paditura lidhur me përvojën e punës dhe lista e pagave numër EM00126465 e lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës për paditësin, kontratës së marrëdhënies së punës e lidhur në mes këtu paditësit dhe të paditurës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet. Kjo për faktin se pala paditëse e ka bazuar kërkesën për kompensimin e pagës jubilarë në Kontratën Kolektive Sektoriale (KKS), mirëpo gjykata duke u bazuar në nenin 2 të KKS (mbi afatin e zbatimit të kontratës) dhe Mendimin Juridik, për shpërblimin jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 27.02.2023, ku në pikën V përcaktohet që kontrata kolektive

sektoriale, aplikohet për periudhën kohore nga data 11.06.2018 - 10.06.2021, ndërsa në pikën IX të po këtij mendimi juridik parashihet që “punëtorët shëndetësor në bazë të Kontratës Kolektive Sektoriale kanë të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 17 të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) gë viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën V, të këtij mendimi juridik dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë në institucione shëndetësore te punëdhënësi i fundit”.

Në bazë të lartcekurave gjykata konstaton se paditësi ka filluar punën tek e paditura me datë 02.05.2019 dhe gjithsej tek e paditura ka 4 vite e nëntë muaj përvojë të punës. Nisur nga dispozitat ligjore të lartëcituar vijnë në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar për arsye se për të fituar të drejtën e shpërblimit jubilar duhet plotësuar këto kushte, 10 vjet përvojë pune dhe atë tek punëdhënësi i fundit që në rastin konkret nga provat e bashkangjitur padisë dhe përgjigjes në padi rezultoi se paditësi nuk i ka 10 vite të përvojës në punë tek e paditura-si punëdhënësi i fundit. Ndërsa përvoja tjetër që paditësi e ka jashtë të paditurës nuk mund të merret parasysh për t’iu njohur kjo e drejtë sepse kushtet janë të numëruara decidivisht, e mos përmbushja e njërit nga ta qon në refuzimin e kërkesëpadisë, ashtu siç u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.*”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, u bazua në nenin 450 të LPK-së, ku secila palë paraprakisht i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Nga arsyet e cekura me lart dhe bazuar në dispozitat e nenit 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4606/2023, 28.02.2024

B. Profesionale
Delvina Ajazaj

Gjyqtarja
Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.